



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS
19-030/01-167302/1, më 16 AUG 2021

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), nenit 3, paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për draft Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal, sipas propozimit të Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm.
- II. Për organizimin e konsultimit publik sipas nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor përgjegjëse është Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm.
- III. Pas konsultimit publik, Drejtoria si në pikën II do të dërgojë një kopje të draft planit, draft raportin e VSM-së, raportin e pjesëmarrjes së publikut dhe trupave konsultues dhe të konsultimit publik tek Ministria përgjegjëse për planifikim, për marrjen e pëlqimit për raportin e VSM-së.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- DPSZHQ;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

